



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Në mbështetje të neneve 13 dhe 58 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 e datës 4 qershor 2008, Ligjit për financat e pushtetit lokal Nr. 03/L-049, Ligjit Nr.05/L-087 për kundërvajtje dhe neneve 40 dhe 41 të Statutit të Komunës së Lipjanit 1Nr.110-623 i datës 26.09.2008, Kryetari i Komunës merr

VENDIM

PËR FORMIMIN E KOMISIONIT PËR HARTIMIN E PROJEKT - RREGULLORES SË RE PËE TAKSA DHE GJOBA KOMUNALE

Neni 1

Përbërja

Formohet Komisioni për hartimin e Projektit të Rregullores së re për Taksa dhe Gjoba komunale, në përbërje si vijon:

1. Fauzë Xhemajli , Drejtorati për Administratë, Kryesues
2. Vlora Krasniqi, Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtare
3. Hanushe Berisha, Drejtorati për Planifikim, Urbanizëm dhe Mbrojtje të Mjedisit, anëtare
4. Rafete Retkoceri, Drejtorati për Shërbime Publike, anëtare
5. Burim Dedushi, Drejtorati për Inspektorat, anëtar
6. Jeton Zymeri, Sektori pronësor-juridik, anëtar
7. Venera Haziri, Drejtorati për Inspektorat, anëtare

Neni 2

Detyrat , përgjegjësitë dhe puna e Komisionit

Komisioni ka për detyrë që duke u bazuar në dispozitat e Ligjit për financat e pushtetit lokal, Ligjit për Kundërvajtje dhe dispozitat tjera ligjore të cilat i japin kompetencë Komunës caktimin e taksave dhe gjobave , të pregadisë Projektin e Rregullores së re për Taksa dhe Gjoba Komunale më së largu deri me datën 10.01.2018 .

Komisioni do të fillojë punën në Zyrën e Drejtorit për Administratë menjëherë pas hyrjes në fuqi të këtij Vendimi.

Neni 3

Hyrja në fuqi

Vendimi hyn në fuqi menjëherë dhe me të njëjtin do të njoftohet Kryesuesi dhe anëtarët e Komisionit .

1Nr. 432-63028

Lipjan, më 23.11.2017

KRYETARI I KOMUNËS

Imri Ahmeti

